

1. Të dhëna të përgjithshme dhe gjëndja ekzistuese e objektit

Skarpata e lumit Lanë ka një sipërfaqe 52,000 m², në segmentin Ura e Drejtorisë së Policisë-Pall. me Shigjeta, në të dyja krahët e tij. Bimësia dekorative e mbjellë vitet e fundit, kërkon ujtitje ç'do tre ditë si domosdoshmëri për mbijetesë, jo vetëm gjatë periudhës së verës, por edhe ç'do periudhë tjetër të vitit kur ka mungesë të rreshjeve të shiut. Në këtë kuadër instalimi i sistemit të ujtitjes në formë shiu (me sprucim) apo dhe i sistemeve të tjera më të avancuara të sipërfaqes së gjelbër dhe bimësisë dekorative (drurë dhe shkurre), do të rrisë ndjeshëm cilësinë e shërbimit të mirëmbajtjes së gjelbërimit. Per furnizimin me ujë të sistemit ujtitës do të përdoren puse me vendodhje: 1- 41°19'17.2"N 19°47'35.9"E, 2- 41°19'16.6"N 19°47'34.5"E, 3- 41°19'16.6"N 19°47'37.5"E.

Puset ndodhen në skarpatën e lumit Lanë dhe sigurojnë sasinë e duhur për ujtitjen normale të sipërfaqes së gjelbër.

Sipërfaqja e gjelbërt (bar dhe bimësi dekorative) kufizohet me koordinatat e paraqitura në tabelën nr.1.

Tabela 1 Koordinatat kufizuese te skarpatave të lumit Lanë

Koordinatat sipas sistemit Gauss Kruger		
Ura e Drejtorisë së Policisë		
1	4400761.22	4577248.55
2	4400766.49	4577220.21
Pallatit me shigjeta		
	4398998.86	4577199.68
	4398967.50	4577188.14



Ortofoto 1 Sipërfaqja e projektit

1. Qëllimi i projekt – zbatimit

Ajo çfarë kërkohet në këto Terma Reference është hartimi i projektit të detajuar të zbatimit për të bërë të mundur ujitjen dhe rivitalizimin e sipërfaqes së gjelbër duke u mbështetur në standartet shqiptare të miratuara. Konsulenti i cili do të marrë përsipër do të gjejë një zgjidhje më të mirë tekniko-ekonomike dhe më ndikim sa më të vogël në mjedis. Kontraktori (konsulenti) duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim të mëparshëm që kanë të bëjnë me këtë objekt. Ai duhet të mbështetet dhe të zbatojë legjislacionin shqiptar për këtë qëllim. Kontraktori (konsulenti) duhet të mbështetet dhe të konsultohet me standartin shqiptar të projektimit sipas **VKM nr.83, datë 10.02.2021 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”** dhe të standarteve të tjera të miratuara nga institucione shqiptare për këto ndërtime.

2. Objektivat

Objektivi primar i realizimit të këtyre Termave, është që të kryhen të gjitha matjet topografike dhe investigimet hidroteknike të duhura për të mbledhur informacionin e saktë dhe të nevojshëm, për hartimin e një projekt-zbatimi dhe ndërtimin e sistemit ujitës për mirëmbajtjen e bimësisë së ndodhur në skarpatën e lumit Lanë.

Objektivi specifik është dhënia e një zgjidhje teknike që siguron sistem ujitës automatik eficient. Hartimi i një projekti të plotë zbatimi që ndër të tjera përmban studimin Topografik, llogaritje hidraulike, skemë të sistemit ujitës automatik, etj. Zgjidhjet teknike të jenë sa më të sigurta dhe me një kosto sa më ekonomike për veprën. Realizimi i punimeve të cilat do të kryhen sipas projekt-zbatimit të miratuar, do të duhet të përmbushë kërkesat:

- Kushteve Teknike të Projektimit të vitit 2015,
- Vendimit të KM nr.722 datë 19.11.1998, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës ndryshuar me: VKM nr.401, datë 22004, VKM nr.545, datë 12.8.2004 dhe VKM nr.574, datë 14.7.2010”
- Vendimi Nr.312, datë 5.5.2010 për miratimin e rregullores "Për Sigurinë në Kantier"

Kërkesa mbi projektin

Konsulenti duhet të realizojë projekt-zbatimin si më poshtë:

- a) Rilevim topografik.
- b) Relacion topografik.
- c) Raportin e llogaritjeve hidraulike të skemës ujitëse automatike (Përcaktimi i sasisë së ujit të nevojshëm për vaditje bazuar në llojet e bimësisë dhe kushtet klimatike).
- d) Skemën e rrjetit ujitës automatik.
- e) Hartimi i skemës së panelit.
- f) Hartimi i një plani të detajuar që përfshin pikën e furnizimit me ujë, vendndodhjen e tubacionit kryesor, tubacioneve sekondare dhe spërkatësve.
- g) Skica dhe detaje të objekteve ndihmëse si puseta, rezervuare, etj.
- h) Vlerësimi i ndikimit mjedisor nëqse objekti i prokurimit klasifikohet në listën e aktiviteteve të cilat duhet të pajisen me Vendim Paraprak bazuar në ligjin nr. 10440, date 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, date 26.02.2015, nr. 128/2020, date 22.10.2020) I përditësuar.
- i) Përcaktimi i Specifikimeve Teknike të pajisjeve hidraulike për ujitje.
- j) Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- k) Analizat teknike të çmimeve për zërat e punës.
- l) Vizatimet teknike të projektit.
- m) Të gjitha fletët e projekteve të jenë saktësisht të dimensionuara, të kuotuar, me akset në të dy drejtimet, dhe saktësisht të dallueshme dhe lexueshme.
- n) Hartimi i preventivit
- o) Grafiku i punimeve.
- p) Deklarata e përgjegjësisë individuale të projektuesit.
- q) Kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.
- r) Licensa individuale me kategoritë përkatëse të shërbimeve që do të kryhen në fushën e studimit-projektimit.

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (Cad, Exel, word, etj.), pdf të nënshkruara elektronikisht.

3. Kërkesat e vecanta

Projektuesi duhet të projektoj panelet e komandimit sipas standarteve bashkëkohore për një funksionim normal të sistemit ujitës.

Shënim: Projektuesi do të shqyrtojë, por nuk do të kufizohet, kërkesat sa më sipër, gjithashtu ai do të jetë në kontakt të ngushtë me stafin e Drejtorise së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit për të diskutuar çdo çështje që konsiderohet e rëndësishme për tu trajtuar gjatë hartimit të projektit.

4. Hartimi i Preventivit

Kosto totale e ndërtimit do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të investitorit në lidhje me standartet e pranuar. Është parashikuar që fondi limit i punimeve të zbatimit mos ta kalojë vlerën **23,375,000** (njëzet e tre milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh.

Çmimet në preventiv do të vendosen, sipas manualit të përditësuar në fuqi **VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”**. Në rastet kur në preventiv ka zëra punimesh të cilat nuk përfshihen në manual, projektuesi dhe preventivuesi janë të detyruar të bëjnë analiza (An) të veçanta çmimesh, të cilat detyrimisht do të jenë pjesë e dosjes së projektit. Përgatitja e preventivit duhet të jetë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave **nr. 216, datë 13.4.2023, “Për sistemin e integruar të informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”**.

Preventivi në fazën përfundimtare të hartimit të tij firmoset detyrimisht nga përfaqësuesi ligjor i firmës (studios) dhe pasi merret në dorëzim nga investitori firmoset dhe nga ky i fundit. Gjatë hartimit dhe paraqitjes së preventivit, të reflektohet ndarja veçmas e strukturës së kostos për punimet ndërtimore dhe teknologjiko-ndërtimore dhe veçmas vlera e furnizimit me pajisje të objektit duke ju referuar **U.K.M. nr.2 datë 8/5/2003 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”**. Në vlerën limit të kostimit të objektit të aplikohet fondi rezerve dhe vlera e TVSH së.

5. Standartet

Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi **VKM nr.83, datë 10.02.2021 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit e të ndërtimit për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”**. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

6. Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për objektin e prokurimit “ Rrjeti ujitës në formë shiu (Seg. Ura e Drejtorisë së Policisë- Pall.me Shigjeta), në të dyja krahët e tij duhet të përmbajë:

- ✓ Rilevim topografik.
- ✓ Projektin e zbatimit (Projektin skemes se vaditjes, detajet e punimeve, detajet e punimeve elektro-mekanike, detajet e punimeve mekanike)
- ✓ Hartimin e skemës elektrike dhe funksionale të panelit të furnizimit me energji elektrike, panelit të komandimit dhe automatizimit të sistemit të ujitjes.
- ✓ Përgatitjen e të gjitha vizatimeve, detajeve teknike, llogaritjeve hidraulike dhe elektrike, si dhe çdo dokumentacioni tjetër teknik të nevojshëm, në mënyrë që projekti të jetë i plotë, i koordinuar dhe i zbatueshëm pa paqartësi gjatë fazës së implementimit.

Relacionet që shoqërojnë projektin duhet të përmbajë:

- ✓ Relacionin topografik.
- ✓ Raportin e llogaritjeve hidraulike të skemës ujitëse automatike (Përcaktimi i sasisë së ujit të nevojshëm për vaditje bazuar në llojet e bimësisë dhe kushtet klimatike).
- ✓ Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nëse objekti i prokurimit klasifikohet në listën e aktiviteteve të cilat duhet të pajisen me Vendim Paraprak bazuar në ligjin nr. 10440, date 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, date 26.02.2015, nr. 128/2020, date 22.10.2020) i përditësuar.
- ✓ Specifikime Teknike të pajisjeve hidraulike për sistemin e ujitjes automatike.
- ✓ Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
- ✓ Analizat teknike të çmimeve për zërat e punës.
- ✓ Preventivi i plotë me çmime njësi dhe pa çmime njësi.

- ✓ Grafiku i punimeve.

Dokumentacioni i kërkuar më sipër të shoqërohet me deklaratën e përgjegjësisë individuale të projektuesit, kopje e policës së sigurimit të projektuesit, për mbulimin e përgjegjësisë profesionale si dhe liçensat individuale me kategoritë përkatëse të shërbimeve që do të kryhen në fushën e studimit-projektimit.

Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet në fazë projekt-zbatimi duhet të paraqiten në format A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Planimetria e përgjithëshme në Shk. 1:500.
2. Planimetria pjesore Shk. 1:100
3. Plani i rievimi Shk. 1:500
4. Skemën e rrjetit ujitës automatik në Shk. 1:500.
5. Skica dhe detaje të objekteve ndihmëse si puseta, rezervuare, etj, Shk. 1:20; 1:50; 1:100
6. Detajet për punimet elektro-mekanike.
7. Detajet për punimet mekanike.
8. Skema e panelit në Shk. 1:20.

Këto terma të referencës do të udhëzojnë procesin e projektimit të rrjetit ujitës automatik për të siguruar mirëmbajtjen e sipërfaqes së gjelbërt dhe bimësisë dekorative që ndodhet në skarpatën e lumit Lanë, në segmentin Ura e Drejtorisë së Policisë deri tek pallati me shigjeta.

7. Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit

7.1 Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

7.2 Në raportin përfundimtar do të përfshihet baza e projektimit të çdo elementi të punimeve, llogaritjet bazuar në projektin final dhe referencat e standarteve të aplikuara.

8. Dorëzimet e raporteve dhe shërbimeve

8.1 Kërkesat për dorëzimin e dokumentacionit dhe shërbimeve

Numri i kopjeve të printuara, si dhe dorëzimi i raporteve dhe shërbimeve tek Autoriteti Kontraktor, do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara më poshtë:

- Dorëzimi i projektit të zbatimit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari.
- Projekti i zbatimit duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur në origjinal nga Kontraktori.
- Projekti i printuar do të dorëzohet në 5 (pesë) kopje të firmosura e vulosura në origjinal dhe në format A₃ me ngjyra.
- Raportet do të dorëzohen të printuara në 5 (pesë) kopje të firmosura e vulosura në origjinal dhe në format A₄.
- Projekti i Zbatimit do të dorëzohet gjithashtu në kopje elektronike (në CD/DVD):
 - 1 CD/DVD në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet AutoCad, Office, etj. ku përshihen projekti, raporti, preventivi dhe specifikimet teknike.
 - 2 CD/DVD në formatin PDF të nënshruar elektronik.

8.2 Në përputhje me nenin 6, pika a, të ligjit nr. Nr. 8402, datë 10.9.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, shërbimi do të konsiderohet i përfunduar dhe i plotë, dhe do të merret në dorëzim përfundimtar vetëm pas marrjes së mendimit pozitiv të opionencës teknike të projekteve nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve. Projektet do të dërgohen për opionencë teknike nga Autoriteti Kontraktor menjëherë pas dorëzimit të tyre nga Konsulenti.

9. Sqarime të fundit

Këto Terma Reference shërbejnë si udhëzues për procesin e projektimit të Rrjetit ujitës në formë shiu (Seg. Ura e Drejtorisë së Policisë- Pall.me Shigjeta).

Operatori ekonomik fitues ka detyrimin që gjatë periudhës së hartimit të projekt preventivit të zbatimit të konsultohet paraprakisht me stafin e specializuar të investitorit, në mënyrë që çdo sygjërim, ndryshim, propozim apo paqartësi mes palëve, të zgjidhen gjatë intervalit kohor të bërjes së projektit, në të kundërt investitori gëzon të drejtën e refuzimit të marrjes në dorëzim, dhe mos financimin e projektit.

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Referuar nenit 34 në Vendim Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim, objekti “Ndërtim rrjeti ujitës në formë shiu, Skarpata e lumit Lanë, Ura Drejtoria e Policisë-Pallati me Shigjeta” (Studim-Projektim) bënë pjesë në:

SEKSIONI III

VEPRAINXHINIERIKE

Grupi I tarifor: